



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:263945

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05730322

K.DH.SH.II.nr.1314/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Komtel Project Engeneering” ShPK me numër të regjistrimit të biznesit 811250836 me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Naser Peci, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës me seli në Prishtinë, dhe palës së interesuar F.R. nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Albana Kelmendi, avokate nga Prishtina, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.47/22 i datës 02.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës paditurit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Inspektoratit të Punës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.47/22 i datës 02.06.2023, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Dhoma e Shkallës së Parë me aktgjykimin e atakuar KA.nr.47/22 i datës 02.06.2023, në pikën I. të dispozitivit, ka vendosur që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Komtel

Project Engineering” ShPK. Anulohet vendimi 01 nr.60-27-1/18 i datës 24.05.2018 i nxjerrë nga i padituri Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës si organ i Shkallës së Parë. Në pikën II të dispozitivit, ky aktgjykim i zëvendëson aktine anuluar dhe ka karakter detyrues. Ndërsa nën pikën III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Inspektorati i Punës me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të Avokaturës Shtetërore për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë të marr aktgjykim me të cilin: aprovohet ankesa e të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës në Prishtinë. Të priset Aktgjykimi KA.nr.47/22 i datës 02.06.2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative dhe të mbetet në fuqi aktvendimi i të paditurës nr.60-27-1/18 i datës 02.06.2023.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se dhe:

Ankesa e të paditurës është **e pa-bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës me vendimin 01 nr.60-27-1/18 i datës 24.05.2018, ka vendosur: Ankesa me nr. 01 96/2018 e dorëzuar në Inspektoratin e Punës me datë 22.02.2018 nga pala në procedurë F.R. për ndërprerje të marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit “Komtel Project Engeneering” ShPK është e bazuar. Obligohet punëdhënësi që në afat prej 8 dite të ndërmarr këto masa” –Të anulohet njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës së ankueses dhe çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe ta trajtojë në harmoni me dispozitat e nenit 53 dhe 76 të Ligjit 03/L-212 të punës. Në pikën I. në bazë të nenit 6.4 të Ligjit nr. 2002/9 dhe 03/L-017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, ankesa e ushtruar kundër vendimit të Inspektorit të Punës, nuk

e shtynë ekspektimin. Nën pikën II. në rast mos zbatimit të vendimit ndaj punëdhënësit do të shqiptohet gjobë konform diapozitave të nenit 92 të Ligjit 03/L-212 të Punës.

Dhoma e Shkallës së Parë duke vepruar sipas padisë me aktgjykimin KA.nr.47/22 i datës 02.06.2023, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka anuluar vendimi i shkallës së parë nën shenjën 01 nr.60-27-1/18 i datës 24.05.2018. Në arsyetim të aktgjykimit Dhoma e Shkallës së Parë ka konstatuar se gjykata vendosi meritorisht për këtë çështje bazuar në nenin 68 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata vlerësoi si të pa bazuara pretendimet e paditësit sepse vlerëson se vendimi i të paditurit është nxjerr nën tejkallim të kompetencave të cilat i ka Inspektorati i Punës sipas Ligjit nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës dhe Ligjin nr.03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin e punës nr.2002/9 këtu ndërlidhur edhe me ligjin e punës i cili përcakton kompetencën për rastet kur i punësuar nuk është i kënaqur me vendimin e punëdhënësit. Lidhur me kompetencën e të paditurit gjykata iu referua nenit 2 të Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, po ashtu gjykata iu referua Ligjit të Punës i cili përcakton se “Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2 të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest në Gjykatën Kompetente”. Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se është kompetencë e gjykatës të vlerësoj nëse ndërprerja e kontratës ka qenë e ligjshme, ndërsa Inspektorati i Punës në Përputhje edhe me nenin 83 të Ligjit të Punës ka mundur të shqiptoj vetëm masë ndëshkimore por jo edhe të obligoj punëdhënësin që të anuloj njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punë se ankueses dhe çështjen ta kthej në rishqyrtim dhe ta trajtoj në harmoni me dispozitat e nenit 53 dhe 76 të Ligjit 03/L-212 të punës. Në nenin 4 të Ligjit nr. 05/L-031 përcaktohen kufizimet e organeve publike që veprimtarinë e tyre ta realizojnë brenda kompetencave të tyre. Gjykata vlerëson se autoriteti i organeve administrative, në këtë rast i padituri Inspektorati i Punës duhet të shtrihet deri në atë masë sa nuk tejkalon kufijtë e kompetencës të cilat me ligj të veçantë janë përcaktuar tek një institucion tjetër në këtë rast të gjykatës. Gjykata shqyrtoj edhe provat tjera të administruara në këtë çështje lidhur me marrëdhënien e punës së palës së interesuar dhe raportet mjekësore, por duke qenë se vlerësoi se i padituri nuk ka pasur kompetencë për vendosje lidhur me anulimin e vendimit të punëdhënësit për kthimin në punë të punësuarit, ndërsa objekt shqyrtimi në këtë konflikt administrativ është shqyrtimi i ligjshmërisë së vendimit kontestues të paditurit, gjykata nuk vlerësoi secilën provë veç e veç pasi që të njëjtat (ligjshmëria e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) nuk ishin objekt shqyrtimi në këtë konflikt administrativ. Gjykata po ashtu iu referua nenit 52 par.1 të LPPA-së i cili përcakton se 1. “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

1.1 është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji, 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë...”. Prandaj gjykata vlerëson se i padituri nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura si dhe nuk ka vepruar në bazë të aktgjykimit A.nr.2354/18 të datës 27.09.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me të cilin është anuluar vendimi nr.343/18 i datës 10.08.2018 dhe çështja është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, andaj gjykata në kuptim të nenit 68 të LKA-së vendosi që të nxjerr vendim si në dispozitiv të aktgjykimit ashtu që i njëjti zëvendëson aktin e organit kompetent. Duke qenë se vendimi i shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës është anuluar me aktgjykimin e lartcekur, gjykata me këtë aktgjykim anuloi vetëm vendimin e shkallës së parë të Inspektoratit të Punës pasi që i njëjti është nxjerrë jashtë kompetencave ligjore.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë e pranon vlerësimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 pika n), ku përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, e sidomos në qoftë se dispozitivi është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtjen e dokumentit ose procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vetë atyre dokumenteve ose të procesverbalit”* e as nenit 194 të LPK -së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, për të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në rastin konkret Dhoma e Shkallës së Dytë e pranon përfundimin e Dhomës së Shkallës së Parë, për shkak se gjykata e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për aprovimin e padisë dhe anulimin e aktit administrativ – vendimin e të paditurës, andaj nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës administrative, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Kolegji vlerësoi se dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, është i qartë dhe nuk është kontradiktor me vetveten ose arsyet e tij, Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka konstatuar se objekt shqyrtimi në konflikt administrativ është shqyrtimi i ligjshmërisë së vendimit kontestues të paditurës, andaj gjykata nuk ka mundur të vlerësoi secilën provë veç

e veç pasi që të njëjtat nuk ishin objekt shqyrtimi në konflikt administrativ, për shkak se organi administrativ i të paditurës nuk ka pasur kompetencë për vendosje lidhur me anulimin e vendimit dhe ka tejkalar kompetencat e tij kur me vendimin 01 nr.60-27-01/18 të datës 24.05.2018 ka obliguar paditësin që në afat prej 8 ditëve ta anuloj njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës së ankueses z. F.R. dhe çështjen ta kthej në rishqyrtim dhe ta trajtoj në harmoni me dispozitat e nenit 53 dhe 76 të Ligjit të punës 03/L-212. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë iu referua nenit 52 par.1 të LPPA-së i cili përcakton se 1. “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1 është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji, 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë...”.

Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë të paditësit dhe anulimit të vendimit të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Kolegji vlerëson se mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale.

Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1314/23, me datë 24.05.2024

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**

Numri i lëndës: 2019:263945
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05730322